



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0161

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga : Vedat Poterqoi - Kryetar Kimete Gashi - Anëtar, Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Gjeokonsult&CO”, me seli në Tiranë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me numër të prokurimit 616-22-7431-3-1-2, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datën 22.05.2023, mori këtë:

Vendim

1. Hedhet si e palejuar ankesa e OE “Gjeokonsult&CO”, me nr. 2023/0161, e datës 24/03/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës me numër të prokurimit 616-22-7431-3-1-2, iniciuar nga AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

2. I Lejohet, autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2.

3. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 09.03.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Rezultatet e Pjesës Teknike për aktivitetit të prokurimit me titull: “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me numër të prokurimit 616-22-7431-3-1-2.

Me datë 14.03.2023, Operatori Ekonomik “Gjeokonsult&CO”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datë 20.03.2023 AK e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e OE ankues dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi rezultatet e pjesës teknike të publikuara nga AK me datë 09.03.2023.

Me datën 24.03.2023 Operatori Ekonomik “Gjeokonsult&CO”, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 161/2023, kundër Njoftimit mbi Rezultatet e Pjesës Teknike për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të kufizuar, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 12 000 000.00 €.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 16.01.2023, eksperti shqyrtues/teknik, ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE “Gjeokonsult&CO”, të aprovohet, si e bazuar.

- të anulohet Vendimi i AK për kualifikimin e Operatorëve Ekonomik dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 13 prill 2023 me raportin e ekspertizës. Me datë 17 prill 2023 AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues/teknik, ndërsa po ashti me datë 17 prill 2023, OE “Gjeokonsult&CO”, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues/teknik.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit dhe konsideron se janë jo kontestuese faktet se AK ka zbatuar në këtë aktivitet të prokurimit procedurën e kufizuar, vlerë e madhe, lloji i kontratës punë, vlera e parashikuar 12,000,000.00 €.

Në fakt, Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar dhe të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaqërisht me RROUPP. Në këtë rast, duke i analizuar në tërësi shkresat e kësaj lënde vërehet se ankuesi është renditur i dyti, me rastin e hapjes së ofertave dhe nga ana tjetër i njëjti nuk i ka parashtruar vërejtjet eventuale në fazat përkatëse të aktivitetit të prokurimit, sepse secili OE disponon me këtë të drejtë. Sidoqoftë, ankuesi ka pohuar se OE i renditur i pari nuk i ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes "*kërkesat minimale, në lidhje me aftësinë teknike dhe profesionale, dhe kapacitetet ekonomike dhe financiare për të kryer një projekt*", mirëpo ato tani e kanë humbur kuptimin e pretendimit prandaj Paneli konstaton se: "...ankuesi e ka humbur afatin ligjor për të paraqitur pretendime ankimore sa i për këtë përshtatshmërisë së kandidatëve, kriterëve të përzgjedhjes apo ndaj çdo kërkesë të paraparë në dokumentin e para-kualifikimit sepse AK e ka mbyllur *fazën e parë* duke i njoftuar të gjithë OE të cilët janë të përfshirë në listën e kualifikimit përmes Letrës standarde të kualifikimit dhe ndaj atij njoftimi, OSHP ka pranuar ankesë nga një OE tjetër ankues dhe jo nga i njëjti OE".

Paneli Shqyrtues sqaron se, bazuar në nenin 49 paragrafi 49.1 të RROUPP-së i hyrë në fuqi me dt. 01.02.2021 i cili ka qenë në fuqi në momentin e inicimit të këtij aktiviteti të prokurimit AK-Komuna e Prishtinës për këtë aktivitet prokurimi ka aplikuar procedurën e kufizuar.

"49.1 Procedura e Kufizuar është një procedure me dy faza.

Është një proces në dy faza, ku vetëm ata Operatorët ekonomik të cilët i plotësojnë kërkesat minimale, në lidhje me aftësinë teknike dhe profesionale, dhe kapacitetet ekonomike dhe financiare për të kryer një projekt, ftohen në tender.

- Në fazën e parë, fazën e Para-kualifikimit, të gjithë Operatorët ekonomik ftohen t'i dorëzojnë kërkesat që të marrin pjesë në procedurë.

Autoriteti Kontraktues zgjedh Operatorët Ekonomik të cilët i plotësojnë kërkesat minimale të kriterëve të përzgjedhjes të specifikuar në njoftimin e kontratës.

- Në fazën e dytë, Faza e dhënies së kontratës, vetëm Operatorët e zgjedhur Ekonomik lejohen të tenderojnë. Autoriteti Kontraktues fton Operatorët e zgjedhur Ekonomik t'i dorëzojnë tenderët dhe i vlerëson tenderët duke përdorur kriteret e dhënies të specifikuar në ftesën për tenderim.

49.2 Operatorët ekonomik që marrin pjesë në Procedurën e Kufizuar quhen "kandidatë".

Më tej RROUPP parasheh edhe Procedurën për shqyrtimin e kërkesave për pjesëmarrje (aplikacioneve) – faza e parë 49.15 Procedura përfshin në thelb dy faza, që do të thotë e para vlerësimi i përgjegjësisë së kandidatëve dhe vlerësimi i pranueshmërinë dhe kualifikimit të kandidatëve.

AK- me dt. 30.11.2022 ka përmbyllur fazën e parë duke publikuar listën e kualifikimit të operatoreve ekonomik, konform nenit 49.15 të RROUPP-së pasi që ka bërë **vlerësimin e pranueshmërisë dhe kualifikimit të kandidatëve** dhe i ka njoftuar kandidatët të cilët janë pjesë e listës së ngushtë, **dhe për këtë mbetet përgjegjësi e vetë autoritetit kontraktues.**

Po ashtu nenin 49.16 i RROUPP-së, kërkon që si masë fillestare, autoriteti kontraktues do të verifikojë nëse kërkesat përmbushin ndonjërin prej kushteve formale të dokumenteve të para-kualifikimit, **me fjalë tjera, përgjegjësinë në kuptim formal.** Një kërkesë konsiderohet të jetë formalisht e plotësuar nëse i plotëson të gjitha kërkesat formale në dokumentet e para-kualifikimit, duke mos u larguar në mënyrë të konsiderueshme nga to ose duke vënë kufizime mbi to. Ndërsa neni 49.22 Pas miratimit të raportit të aplikacioneve nga ZPP, AK do të përgatite

dhe publikoj Formularin B58 Njoftimin mbi vendimin e AK ne platformën e prokurimit elektronik. Pra bazuar në Letrën standarde të para kualifikimit AK me dt. 30.11.2022 ka përmbyllur fazën e parë.

Pas përfundimit të afatit për ankesa AK, duhet të filloj fazën e dytë përmes ftesës së tenderimit dhe të dërgohet vetëm tek OE të kualifikuar në fazën e parë.

“Ftesa për tenderim 49.23 Në lidhje me nenin 50 të LPP-së, kandidatët e para-kualifikuar të përzgjedhur do të ftohen të tenderojnë në të njëjtën kohë. 49.24 Në ftesën për tenderim si dhe në dosjen e tenderit, afati i fundit për kërkesën e mundshme të kandidatëve për informata shtesë ose qartësuese do të specifikohet sipas nenit 53.1 të LPP-së.

– Faza e dytë 49.25 Procedura e shqyrtimit përfshin në thelb dy faza, **e para është vlerësimi i përgjegjësive formale të tenderëve dhe pastaj vlerësimi teknik i tenderit** si i tillë. Në fazën e dytë bëhet vetëm vlerësimi formal konform nenit 49.26 Si masë fillestare, autoriteti kontraktues do të verifikojë nëse kërkesat përmbushin ndonjërin prej kushteve formale të dokumenteve të tenderit, me fjalë tjera, vlefshmërinë ne kuptim formal.

Më tej PSH konsideron se eksperti shqyrtues profesional i prokurimit nuk ka shpjeguar drejtë çështjen, duke devijuar nga legjislacioni sekondar si dhe nga interpretimi i KRPP i dt. 31.03.2023 por edhe nga vendimet paraprake të OSHP. Për këtë Paneli shqyrtues ka kërkuar nga KRPP zbërthimin e këtij interpretimi sa i përket ankesave në procedurën e kufizuar dhe me dt. 19.05.2023 pas takimit të mbajtur me KRPP është arritur në përfundim që përmes emailit të na drejtohen me shkrim rreth interpretimit të tyre të lartëcekur.

KRPP po me këtë dt. 19.05.2023 e dërgon email tek Paneli Shqyrtues duke cituar:

"Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), në takimin e mbajtur me datë 19.05.2023, ku temë e diskutimit ka qenë rregullat dhe ankesat në Procedurën e Kufizuar.

Lidhur me këtë çështje, KRPP ka sqaruar rregullat për Procedurën e Kufizuar si në vijim:

Paragrafet 47.1-47.3 të Rregullores për Prokurimin Publik, përcaktojnë:

“**47.1** Procedura e Kufizuar është një procedure me dy faza, ku vetëm ata Operatorë ekonomik të cilët i plotësojnë kërkesat minimale, në lidhje me aftësinë teknike dhe profesionale, dhe kapacitetet ekonomike dhe financiare për të kryer një projekt, ftohen në tender.

a. Në fazën e parë, fazën e Para-kualifikimit, të gjithë Operatorët ekonomik ftohen t’i dorëzojnë kërkesat që të marrin pjesë në procedurë. Autoriteti Kontraktues zgjedh Operatorët Ekonomik të cilët i plotësojnë kërkesat minimale të kriterëve të përzgjedhjes të specifikuara në njoftimin e kontratës.

b. Në fazën e dytë, faza e dhënies së kontratës, vetëm Operatorët Ekonomik të zgjedhur lejohen të tenderojnë. Autoriteti Kontraktues fton Operatorët e zgjedhur Ekonomik t'i dorëzojnë tenderët dhe i vlerëson tenderët duke përdorur kriteret e dhënies të specifikuara në ftesën për tenderim.

47.2 Procedura e kufizuar siç përcaktohet në Nenin 4.1.53 të Ligjit për Prokurim Publik është një procedurë e prokurimit që i lejon çdo Operatori ekonomik të kërkojë të marrë pjesë, ndërsa lejon vetëm ata Operatorë ekonomik të kualifikuar nga autoriteti kontraktues për të dorëzuar një tender. Kjo do të thotë se do të jetë një mundësi e hapur për Operatorët e interesuar ekonomik që të aplikojnë për para-kualifikim.

47.3 Pas afatit kohor për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues vlerëson kualifikimin e kandidatëve, në përputhje me kërkesat e publikuara për kualifikim. Kandidatët që i plotësojnë kushtet e kërkuara për kualifikim ftohen për të dorëzuar tenderin. Kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit eliminohen. Kandidatët e ftuar në tender duhet të dorëzojnë tenderët sipas afatit kohor të specifikuar në dosjen e tenderit. Mbahet një hapje publike e tenderëve. Tenderët vlerësohen në përputhje me kriteret e dhënies të specifikuara në dosje të tenderit dhe kontrata i jepet kandidatit fitues”.

Ndërsa, sa i përket ankesave në procedurën e kufizuar, KRPP sqaron se, Paragrafi 1 i nenit 108/A të LPP-së, përcakton:

"1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit".

Po ashtu, paragrafi 1 dhe paragrafi 3 i nenit 59 të Rregullores për Prokurim Publik, përcaktojnë :

59.1 Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar **në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit** dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që pretendohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij pranë Autoritetit kontraktues i cili udhëheq aktivitetin e prokurimit. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.

59.3 Në përputhje me paragrafin 1 të nenin 109 të LPP-se, ankesa pranë OSHP-se mund të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes. Pra, fillimisht ankesa do të dorëzohet tek Autoriteti Kontraktues dhe në rast se pala e interesuar nuk është e kënaqur me vendimin e marrur nga Autoriteti Kontraktues në fjale, mund të parashtrij ankesë pranë OSHP-se.

Në përputhje me nenet e lartë cituara, gjatë procedurës së kufizuar secili OE pjesëmarrës në aktivitetet të prokurimit i cili pretendon se është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar mund të parashtrij kërkesë për rishqyrtim në Autoritetin kontraktues si në fazën e para-kualifikimit ashtu edhe në fazën e dhënies së kontratës, po ashtu në rast se pala e interesuar nuk është e kënaqur me vendimin e AK-së, mundë të parashtrijë një ankesë në përputhje me nenin 109 të LPP-së.

Pra, OE ka të drejtë të parashtrij kërkesë për rishqyrtim në Autoritetin kontraktues si në fazën e parë ashtu edhe në fazën e dytë, por, gjatë fazës së dytë (në fazën e dhënies së kontratës), OE nuk mund të parashtrij kërkesë për rishqyrtim për kërkesat e fazës e parë, sepse kur fillohet me fazën e dytë, faza e parë konsiderohet e mbyllur."

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë dhënë shpjegime të drejta. Paneli vëren se arsyet e dhena në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish dhe veprimet e AK janë në përputhje me interpretimin e KRPP.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër, Paneli konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP, sepse në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik. Nga shqyrtimi i shkresave të kësaj lënde dhe i rrjedhës së prokurimit, Paneli po ashtu nuk gjeti ndonjë provë sipas së cilës mund të konstatohet shkelja e nenit 1 dhe synimi i AK për shfrytëzim jo efikas dhe jo transparent të parasë publike, sipas nenit 6 të LPP. Ankuesi ka pohuar se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk iu ka përmbajtur dispozitave të këtij neni duke shkelur nenin 60 të LPP-së gjatë procesit të vlerësimit, krahasimit dhe poentimit të tenderëve.

- Përfundim -

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP dhe ka zbatuar drejtë dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 27, sipas të cilit, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshme ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese.

Paneli Shqyrtues nisët gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - GJEOKONSULT&CO**
- Arkivës së OSHP-së: